



QEVERIA E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

Agjencioni për përkrahje financiare në bujqësinë dhe zhvillimin rural

Rr. Skupi 3-a, 1000 Shkup

Në bazë të nenit 14 paragrafi 2 (a) nga Ligji për ratifikim të Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Maqedonisë dhe Komisionit i Bashkësive Evropiane për rregullat për bashkëpunim në aspekt të ndihmës financiare prej KE të Republikës së Maqedonisë dhe zbatimin e ndihmës sipas komponentit V (IPARD) prej instrumentit për ndihmë parahyrëse "Gaz. zyrtare e RM " nr. 165/2008) dhe në bazë të Pjesës V paragrafi (5) prej Programit për shfrytëzimin e mjeteve prej Instrumentit për ndihmë parahyrëse për zhvillim rural të Bashkimit Evropian (IPARD) për periudhën 2007-2013 "Gaz. zyrtare e RM " nr. 83/2009),

Agjencia për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillimin rural

më 23 dhjetor të vitit 2009 shpall

THIRJE PUBLIKE nr.01/2009

për dorëzimin e kërkesave për shfrytëzimin e mjeteve prej
IPARD Programit 2007-2013

Agjencia për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillimin rural (në tekstin e më tutjeshëm : Agjencia) si institut kompetent dhe organ kontraktues për zbatimin e marrëveshjes të Instrumentit për ndihmë parahyrëse për zhvillim rural të UE (IPARD) u bën thirrje të gjithë të interesuarve persona fizik dhe juridik prej Republikës së Maqedonisë të dorëzojnë kërkesa për shfrytëzimin e mjeteve prej IPARD Programit 2007-2013 për masat në vijim:

Masa 101 – Investime në ekonomitë bujqësore me qëllim të ristrukturimit dhe mbindërtimit të tyre për arritjen e standardeve të Bashkimit evropian

Masa 103 - Investime për përpunim dhe marketing për prodhimet bujqësore dhe të peshkut me ristrukturimin dhe mbindërtimit të tyre për arritjen e standardeve të Bashkimit Evropian

Masa 302 – Diverzifikim dhe zhvillim të aktiviteteve ekonomike rurale

1. Shuma e përgjithshme e mjeteve financiare për zbatimin e e kësaj Thirrje publike në euro është 24.320.000 apo në denarë 1.494.150.272, nga të cilat 75% prej mjeteve janë të siguruara nga Bashkimi Evropian dhe 25% prej mjeteve janë të siguruara nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë.

2. Mjetet financiare sipas kërkesave individuale jepen si përkrahje financiare e pakthyeshme (grant) në vlerë prej 50% nga vlera e shpenzimeve të pranueshme, gjegjësisht 55% për kërkesë të dorëzuar nga bartësi i ekonomisë bujqësore jo më i vjetër se 40 vjet nga dita e dorëzimit të kërkesës për shfrytëzimin e mjeteve sipas masës 101.

3. Afati I fundit për dorëzimin e kërkesës është 23.02.2010, deri në ora 16:30 sipas orës lokale.

4. Marrja e formularëve dhe udhëzimeve:

Formularët e duhur prej „Kërkesë për shfrytëzimin e mjeteve prej IPARD Programit 2007-2013“ si dhe „Udhëzimi për shfrytëzuesit e mjeteve prej IPARD Programit 2007-2013“ në të cilin janë të përfshira të gjitha informatat për kriteret, kushtet për pranueshmëri të projekteve dhe kushteve për financim dhe informata të tjera të cilat janë të domosdoshme



Instrument për ndihmë parahyrëse të Bashkimit Evropian
për zhvillim rural për 2007-2013



për përgatitjen e kërkesës për shfrytëzimin e mjeteve të IPARD Programit 2007-2013, në versionin elektronik mund të merren në ueb-adresën e Agjencionit: www.ipardpa.gov.mk.

Formularët në formë të shtypur prej kërkesës për shfrytëzimin e mjeteve të IPARD Programit 2007-2013, dhe Udhëzimit për shfrytëzuesit e mjeteve të IPARD Programit 2007-2013 mund të merren drejtpërdrejt në Agjencion në adresën:

Agjencioni për përkrahje financiare në bujqësinë dhe zhvillimin rural,

rr. Skupi nr. 3-a, (ndërtesa e Fonko)

1000 Shkup

dhe në qendrat më të afërta rajonale ose njësitet punuese të **Agjencionit për nxitje të zhvillimit në bujqësi** çdo ditë pune prej **orës 8:30 deri ora 16:30**.

5. Mënyra e dorëzimit të kërkesës:

Kërkuesit duhet të dorëzojnë Kërkesë për shfrytëzimin e mjeteve prej IPARD Programit 2007-2013 për masa individuale, plan afarist me të cilët l përshkruajnë llojet e planifikuara të investimeve dhe dokumentacionin plotësues e cekur në Kërkesën për shfrytëzimin e mjeteve prej IPARD Programit 2007-2013. Informata më detale për kërkesat specifike për pranueshmëri janë të cekur në *Udhëzimin për shfrytëzuesit e mjeteve të IPARD Programit 2007-2013*.

Kërkesat e plotësuara për shfrytëzimin e mjeteve prej IPARD Programit 2007-2013 në gjuhën maqedonase së bashku me dokumentacionin e duhur të plotë dorëzohen në zarf të mbyllur me shenjë në pjesën e përparme të zarfit lartë në qoshin e majtë "MOS E HAP" për Thirrje publike IPARD numër 01/2009 dhe shënimin e shifrës të masës për të cilën e dorëzon kërkesën. Kërkesa mund të dorëzohet me postë si dërgesë e rekomanduar apo personalisht në arkivin e Agjencionit.

Informata në detaje në kontakt tel. (02) 3097-450 ose në kontakt e-mail adresën: ipardpa.info@ipardpa.gov.mk dhe në ueb-faqen: www.ipardpa.gov.mk.

Drejtime të përgjithshme për përgatitjen e kërkesës të Shpalljes publike nr. 01/2009

1.	Qëllimet e përgjithshme të IPARD Programit 2007-2013
	<p>Qëllimi i IPARD Programit 2007-2013 është nëpërmjet masave të përshtatshme për përkrahje të zhvillimit bujqësor dhe rural që të përmirësohet konkurrimi i prodhimeve bujqësore dhe sektori bujqësor-ushqimor nëpërmjet dakordimit të tyre me standardet e Bashkimit evropian dhe arritje të ambientit jetësor të qëndrueshëm dhe zhvillim socio-ekonomik të hapësirave rurale përmes nxitjes së aktiviteteve ekonomike dhe rritjen e mundësive për punësim, nëpërmjet prioriteteve në vijim:</p> <ul style="list-style-type: none">- përmirësim i konkurrencës për ekonomi bujqësore të qëndrueshme dhe kapacitete bujqësore-ushqimore të nën-sektoreve të caktuara nëpërmjet investimeve të dedikuara për përmirësimin e infrastrukturës teknologjike dhe të tregut me qëllim që të rrit vlerën e shtuar të prodhimeve bujqësore që të arrihen standardet e Bashkimit evropian për cilësi, korrektësi shëndetësore, siguri shëndetësore, mirëqenien e kafshëve dhe standardet për mbrojtjen e mjedisit.- përmirësimin e cilësisë së jetës të popullatës rurale, rritjen e të ardhurave në mjediset rurale dhe krijimin e mundësive për punësim të reja përmes zhvillimit dhe diversifikimit të aftësive ekonomike të ekonomive bujqësore që të mos zvogëlohet pabarazia ndërmjet rajoneve dhe në krahasim me mjediset urbane.
2.	Prioritete për dhënie e përkrahjes financiare
	<p>Në pajtim me qëllimet e IPARD Programit 2007-2013, prioritetet kryesore për përkrahjen financiare janë në vijim:</p> <p>a) Në pajtim me Prioritetin - Boshti 1 – Përmirësimin e efikasitetit të tregut dhe implementimin e standardeve të Bashkimit evropian:</p> <p>Masa 101 – Investime në ekonomitë bujqësore me qëllim të ristrukturimit dhe mbindërtimit për arritjen e standardeve të Bashkimit Evropian</p> <p>Masa 103 - Investime për përpunim dhe marketing për prodhimet bujqësore dhe të peshkut me ristrukturimin dhe mbindërtimin e tyre për arritjen e standardeve të Bashkimit Evropian</p>



	6) Në pajtim me Prioritetin - Boshti 3 – Zhvillim të ekonomisë në mjediset rurale: Masa 302 - Diverzifikim dhe zhvillim të aktiviteteve ekonomike rurale
3.	Lënda dhe kushtet për shfrytëzimin e përkrahjes financiare për masën 101
	Përkrahja financiare për masën 101 është dedikuar për prodhimet bujqësore në sektorët prioritarë vreshtari (1011), pemëtari (1012), kopshtari (1013), kultivimin e bagëtisë qumështore për prodhim primar të qumështit të papërpunuar (1014) dhe kultivimin e bagëtisë dhe shpendarisë për shumim për prodhim të mishit (1015). Grupet e investimeve të sektorëve prioritarë u dedikohen llojeve të investimeve në vijim:
Shifra	Lloji I investimit
10111	Përtrirja e fidanëve hordhive ekzistuese
10121	Përtirja e fidanëve pemëve ekzistuese
10131	Ndërtimin dhe përtrirjen e serave prej plasmasi (në përjashtim të serave në formë tuneli)
10132	Ndërtimin dhe përtrirjen serave ekzistuese prej qelqi
10133	Ndërtimin dhe përtrirjen e objekteve për aktivitetet pas vjeljes në serat ekzistuese prej plasmasi dhe qelqi (në përjashtim të serave në formë tuneli)
10134	Modernizimi I prodhimit të perimeve në ambient të hapur
10141	Ndërtim/përtrirje të objekteve për ruajtjen e lopëve, dhenve dhe dhive që milen
10142	Furnizim me pajisje për mjelje, ftohje dhe deponim të qumështit
10151	Ndërtim/përtrirje të objekteve për ruajtjen e derrave për shumim
10152	Vendosjen e kapaciteteve të reja të shpendarisë në ekonomitë bujqësore për ruajtjen e zogjëve dhe modernizimin e atyre ekzistuese
3.1.	Shfrytëzuesit e masës 101 mund të jenë ekonomi bujqësore, që i plotësojnë kushtet në vijim: 1) janë të regjistruar në Regjistrin e vetëm për ekonomi bujqësore në MBPE në pajtim me Ligjin për zhvillim bujqësor dhe rural („Gaz. zyrtare e RM“ nr. 134/07) si: a) Prodhues individual bujqësor – persona fizik të cilët merren me bujqësi në emër të vet dhe llogari të vet si bartës i ekonomisë bujqësore i cili është pronar i pronës bujqësore apo ka të drejtë për shfrytëzimin e pronës bujqësore të ekonomisë bujqësore në bazë të kontratës; b) Tregtar-individ , në pajtim me Ligjin për shoqatat tregtare („Gaz. zyrtare e RM “ nr. 28/04, 84/05, 25/07, 87/08), e cila është kryerje e aktiviteteve bujqësore të profilit të tij/sajë dhe janë të regjistruar si të tillë në Regjistrin qendror, [sipas Klasifikimit nacional të aktiviteteve ekonomike („Gaz. zyrtare e RM “ nr. 147/08)]; c) Shoqata tregtare në pronësi private e themeluar në pajtim me Ligjin për shoqata tregtare („Gaz. zyrtare e RM“ nr. 28/04, 84/05, 25/07, 87/08) e cila merret me bujqësi, si aktivitet primar ekonomik dhe janë të regjistruara sit ë tilla në Regjistrin qendror [sipas Klasifikimit nacional të aktiviteteve ekonomike („Gaz. zyrtare e RM “ nr. 147/08)]; ç) Kooperativa të themeluara në pajtim me Ligjin për kooperativa („Gaz. zyrtare e RM“ nr. 54/02, 84/05) e cila merret me bujqësi, si aktivitet primar ekonomik dhe janë të regjistruara si të tilla në Regjistrin qendror [sipas Klasifikimit nacional të aktiviteteve ekonomike („Gaz. zyrtare e RM “ nr. 147/08)]; d) Persona fizik dhe juridik (tregtar individual dhe shoqatat tregtare në pronësi private të themeluara në pajtim me Ligjin për shoqata tregtare („Gaz. zyrtare e RM “ nr. 28/04, 84/05, 25/07, 87/08), të cilat merren me veprimtari bujqësore derisa i plotësojnë kushtet e veçanta për madhësinë e kapacitet prodhues të shfrytëzuesve të sektorëve më prioritet



2) Madhësia e kapaciteteve prodhuese të ekonomive bujqësore:

Shfrytëzues	Sektor me prioritet	Grupe e investimeve	Njësia masa	Madhësia e kapaciteteve të pranueshme	
				Min.	Maks.
Prodhuesi individual bujqësor					
<i>Bujqësi</i>	1011 Fidanë hordhi				
		10111	Ha	0.5	20
	1012 Kopsht pemësh				
		10121	Ha	0.5	15
	1013 Kopshtari				
	- ser.plasmasi	10131;10133	ha	0.3	3
	- ser.qelqi	10132; 10133;	ha	0.1	2.5
- ambient të hapur	10134	ha	0.5	15	
<i>Blegtori</i>	1014 Prodhimtari primare të qumështit të papërpunuar				
	- lopë qumështore	10141; 10142	kokë	10	100
	- dhi qumështore	10141; 10142	kokë	50	500
	- dhen qumështor	10141; 10142	kokë	300	3,000
	1015 Prodhim të mishit				
	- derra për shumim	10151	kokë*	2,000	8,000
	- derra	10151	kokë	40	100
- zogj	10152	zogj*	5,000	30,000	
Kooperativat bujqësore, persona juridik që merren me bujqësi, shoqata tregtare që hyjnë në aktivite bujqësore					
<i>Bujqësi</i>	1011 Fidanë hordhi				
		10111	ha	0.5	50
	1012 Kopsht pemësh				
		10121	ha	0.5	30
	1013 Fidanë perimesh				
	- ser.plasmasi	10131;10133	ha	1.0	8
	- ser.qelqi	10132;10133	ha	1.5	6
- ambient të hapur	10134	ha	0.5	30	
<i>Blegtori</i>	1014 Prodhime të qumështit				
	- lopë qumështore	10141; 10142	kokë	15	150
	- dhi qumështore	10141; 10142	kokë	80	800
	- dhen qumështor	10141; 10142	kokë	500	8,000
	1015 Prodhimi i mishit				
	- derra	10151	kokë *	2,000	30,000
	-derra	10151	kokë	40	400
- zogj	10152	zogj*	5,000	60,000	

* Qarkullim vjetor



	<p>3) Personi përgjegjës i ekonomisë bujqësore:</p> <ul style="list-style-type: none"> - duhet të ketë të kryer minimum shkollim të mesëm apo të posedon certifikatë për trajnim lidhur me investimin - nuk mund të jetë më i vjetër se 59 vite vjetërsi (për burra) dhe 57 vite vjetërsi (për gra) duke pasur parasysh kufirin për pensionim prej 64 vite për burra dhe 62 për gra në pajtim me rregullat na Ligji për sigurim pensional dhe invalidor "Gaz. zyrtare e RM" nr. 80/93, 14/95, 71/96, 32/97, 24/00, 96/00, 5/01, 85/03, 50/04, 4/05, 84/05, 101/05, 70/06), 153/07, 152/08, 161/08, 81/09). - personi përgjegjës i personit juridik patjetër të jetë i punësuar në kohë të pacaktuar
<p>3.2.</p>	<p>Lartësia e financimit sipas masës 101</p> <p>Vlera minimale të shpenzimeve të pranueshme është 5 000 euro (307.185 në kundërvlerë denari)</p> <p>Vlera maksimale të shpenzimeve të pranueshme nuk mund ta kalon:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 200 000 euro (12.287.420 në kundërvlerë denari) nga shpenzimet e përgjithshme të pranueshme të investimeve qëllimi i të cilës është që të arrihen standardet e Bashkësisë Evropiane pas realizimit të investimeve apo - 400 000 euro (24.574.840 në kundërvlerë denari) shpenzimet e përgjithshme të pranueshme të investimeve qëllimi i të cilës është pajtimi i plotë i ekonomive bujqësore me standardet e Bashkësisë Evropiane pas realizimit të investimeve . <p>Kufizimet tjera financiare të cilat do të zbatohen:</p> <p>a) Për përrirjen e mbjelljeve shumëvjeçare:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Shpenzimet e pranueshme të investimeve në furnizimin e pajisjeve bujqësore (në përjashtim të shpenzimeve të përgjithshme të pranueshme për investim në sistemin për ujitje) nuk duhet të kalojnë 35% prej shpenzimeve të pranueshme të parapara në kuadër të buxhetit të projektit; - Shpenzimet e përgjithshme të pranueshme të investimeve në furnizimin e pajisjeve (në përjashtim të shpenzimeve të përgjithshme të pranueshme për investim në sistemin për ujitje) nuk duhet të kalojnë 70 000 euro (24.574.840 në kundërvlerë denari) për projekt i cili ka për qëllim vetëm mbindërtim dhe modernizim të aktiviteteve bujqësore për përpunimin e mbjelljeve shumëvjeçare; <p>b) Për ndërtim dhe rikonstruim të oranzherive</p> <ul style="list-style-type: none"> - Shpenzimet e përgjithshme të pranueshme të investimeve në furnizimin e pajisjeve bujqësore (në përjashtim të shpenzimeve të përgjithshme të pranueshme për investim në sistemin për ujitje) nuk duhet të kalojnë 25% shpenzimeve të përgjithshme të pranueshme të parapara në kuadër të buxhetit të projektit, derisa projekti i përgjithshëm ka për qëllim rikonstruimin e serave prej plasmasi dhe qelqi të përhershme (me përjashtim të serave në formë tuneli); - Shpenzimet e përgjithshme të pranueshme të investimeve në furnizimin e pajisjeve bujqësore (në përjashtim të shpenzimeve të përgjithshme të pranueshme për investim në sistemin për ujitje) nuk duhet të kalojnë 50 000 euro (3.071.855 në kundërvlerë denari) nëse projekti i përgjithshëm ka për qëllim vetëm mbindërtim dhe modernizim të aktiviteteve bujqësore për kultivimin e pemëve në sera të plasmasit apo në fusha të hapura (me përjashtim të serave në formë tuneli); <p>c) Për ndërtim dhe rikonstruim të objekteve për ruajtjen e blegtorisë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Shpenzimet e përgjithshme të pranueshme të investimeve në pajisje për ruajtjen e ushqimit për bagëti dhe pajisje të specializuara për prodhimin e ushqimit për bagëti nuk duhet të kalojnë 45% prej shpenzimeve të përgjithshme të pranueshme (me përjashtim të shpenzimeve të përgjithshme të pranueshme) të parapara në kuadër të buxhetit të projektit, derisa projekti i përgjithshëm ka për qëllim rikonstruimin e objekteve shoqëruese për deponim dhe ruajtjen e ushqimit të bagëtisë dhe ahrit; - Shpenzimet e përgjithshme të pranueshme të investimeve në pajisje të specializuara për prodhimin e ushqimit për bagëti nuk duhet të kalojnë 25% prej shpenzimeve të përgjithshme të pranueshme për investime (me përjashtim të shpenzimeve të përgjithshme të pranueshme) të parapara në kuadër të buxhetit të projektit, derisa projekti i përgjithshëm ka për qëllim rikonstruimin e objekteve për ruajtjen e derrave për shumim, dhe përfshirë dhe renovimin objekteve për deponim të ushqimit për bagëti; - Shpenzimet e përgjithshme të pranueshme të investimeve në furnizimin e pajisjeve nuk duhet të kalojnë 90 000e uro (5.529.339 në kundërvlerë denari) derisa projekti i përgjithshëm ka për qëllim vetëm



	<p>mbindërtim dhe modernizim të aktiviteteve bujqësore për ruajtjen e derrave për shumim dhe zogjve;</p> <p>Vlera maksimale e shpenzimeve të pranueshme për ko-financim të një shfrytëzuesi nuk mund të kalojë 530 000 euro në kuadër të periudhës financiare 2007-2013.</p> <p>Një shfrytëzues mund të dorëzon më shumë kërkesa për shfrytëzimin e mjeteve prej IPARD Programit 2007-2013, me kusht që të mos e kalon lerën maksimale të shpenzimeve të pranueshme për financim dhe nëse projektet e mëparshme janë me sukses të përfunduara, gjegjësisht përkrahja financiare është plotësisht e paguar.</p>
4.	Lënda dhe kushtet për shfrytëzimin e përkrahjes financiare për masën 103
	<p>Përkrahja financiare për masën 103 është e dedikuar për sektorin e bujqësisë-ushqimit në sektoret me prioritet ventari (1031), përpunim dhe plasma të pemëve dhe perimeve (1032), përpunim të qumështit dhe prodhim të produkteve të qumështit (1033), prodhim të mishit të freskët dhe përpunimet e mishit (1034).</p> <p>Grupet e investimeve të sektoreve me prioritet u dedikohen llojeve të investimeve në vijim:</p>
shifra	Lloji i investimit
10311	Investime për furnizim me pajisje për përmirësimin e cilësisë së venës
10321	Investime për ndërtimin dhe përrirjen e objekteve për vendosjen dhe modernizimin e qendrave blerëse të pemëve dhe perimeve
10322	Investime për ndërtimin të pajisjeve dhe përmirësim të teknologjive për prodhim në kapacitetet për përpunimin e pemëve dhe perimeve
10331	Investime për ndërtimin dhe përrirjen e objekteve për vendosjen dhe modernizimin e qendrave për grumbullim të qumështit
10332	Investime për modernizimin dhe teknologji bashkëkohore të kapaciteteve të specializuara për përpunimin e mishit
10341	Investime për vendosjen e kapaciteteve për thertore për shpendari
10342	Modernizim dhe teknologji bashkëkohore të linjave ekzistuese të thertoreve për lopë, dera dhe shpezë
10343	Investime në kapacitetet për thertore për përpunimin e mishit për mbrojtjen e ambientit jetësor
4.1.	<p>Shfrytëzues të masës 103 mund të jenë persona juridik të qëndrueshëm ekonomikisht të cilët i plotësojnë kushtet në vijim:</p> <p>a) janë themeluar në pajtim me Ligjin për shoqata tregtare („Gaz. zyrtare e RM“ nr. 28/04, 84/05, 25/07, 87/08) si ndërmarrje të vogla dhe të mesme, pa kapital shtetëror në strukturën personale të ndërmarrjes - personat juridik të cilët punësojnë nga 250 persona dhe kanë qarkullim vjetor i cili nuk kalon 50 milion euro, dhe / apo bilanc vjetor të përgjithshëm të gjendjes nuk kalon 43 milion euro mund të jenë shfrytëzues potencial derisa investimi është dedikuar për pjesë të ndërmarrjes për përputhshmëri të plotë me standardet e Bashkimit Evropian.</p> <p>b) kooperativa të cilat janë të regjistruara në Regjistrin qendror sipas Ligjit për kooperativa („Gaz. zyrtare e RM“ nr. 54/02, 84/05) me veprimtari bujqësore sipas Klasifikimit nacional të aktiviteteve ekonomike („Gaz. zyrtare e RM“ nr. 147/08) (vetëm për projekte që kanë për qëllim ndërtimin dhe përrirjen e qendrave për grumbullim (lloji i investimit 10321 dhe 10331).</p> <p>c) janë të regjistruar në sistem të TVSH në pajtim me Ligjin për TVSH („Gaz. zyrtare e RM“ nr.44/99,59/99,86/99,11/00, 8 / 01, 21/03, 19/04, 33/06, 101/06, 114/07, 103/08)</p> <p>ç) të plotësojnë kushte përkatëse për kryerjen e veprimtarisë përkatëse për përpunimin e prodhimeve bujqësore në pajtim me Ligjin për siguri të ushqimit dhe prodhimet dhe materialet që vijnë në kontakt me ushqimin („Gaz. zyrtare e RM“ nr. 54/2002, 84/2007) dhe Ligji për shëndet publik veterinarie.</p> <p>2) Madhësia e kapaciteteve prodhuese:</p>



2) Madhësia e kapaciteteve prodhuese:

Sektor me prioritet	Shfrytëzues	Grupa e investimeve	Njësia masa **	Madhësia e kapaciteteve të pranueshme	
				Min.	Maks.
1031 Ventari					
		10311	hl	1,500	55,000
1032 Përpunimi I pemëve dhe perimeve:					
- kapacitet për grumbullim /kapacitet për ftohje dhe deponim		10321	ton	500	3,000
- tharje		10322	ton	40	500
- ngrirje		10322	ton	500	5,000
Konservim		10322	ton	500	5,000
1033 Përpunim të qumështit dhe prodhimeve të qumështit:					
- kapacitet për grumbullim /kapacitet për ftohje dhe deponim		10331	litër në ditë	1,500	30,000
- kapacitet për përpunim		10332	litër në ditë	5,000	100,000
1034 Prodhimet e mishit					
Kapacitet për therje	-shpezë	10341; 10342; 10343	Kokë në dit	5,500	30,000
	-lopë	10342; 10343	Kokë në dit	15	150
	-derra	10342; 10343	Kokë në dit	20	300
	-qengja	10343	Kokë në dit	50	4,000
Përpunim të mishit	- ndërmarrje për përpunim	10343	ton	2,000	25,000

**kapacitete të instaluar:

- për venë, e shprehur në hektolitra për vit
- për pemë dhe perime, e shprehur në ton për vit
- për qumësht dhe prodhime të qumështit, e shprehur në litra për vit
- për therje, e shprehur për kokë në ditë
- për përpunimin e mishit, e shprehur në ton për vit

3) Personi përgjegjës i personit juridik:

- duhet të posedon shkollim profesional në pajtim me Rregulloren për mënyrën e kontrollit për dituri dhe mënyrën për dhënie të vërtetimeve për dituri themelore të fituar për higjienë të ushqimit dhe mbrojtje të mjedisit jetësor („Gaz. zyrtare e RM“ nr. 118/2005),
- nuk mund të jetë më i vjetër se 59 vite vjetërsi (për burra) dhe 57 vite vjetërsi (për gra) duke pasur parasysh kufirin për pensionim prej 64 vite për burra dhe 62 për gra në pajtim me rregullat na Ligji për sigurim pensional dhe invalidor “Gaz. zyrtare e RM” nr. 80/93, 14/95, 71/96, 32/97, 24/00, 96/00, 5/01, 85/03, 50/04, 4/05, 84/05, 101/05, 70/06), 153/07, 152/08, 161/08, 81/09).
- personi përgjegjës i personit juridik patjetër të jetë i punësuar në kohë të pacaktuar



4.2.	Lartësia e financimit sipas masës 103
	<p>Vlera minimale të shpenzimeve të pranueshme është 15 000 euro (921.556 në kundërvlerë denari)</p> <p>Vlera maksimale të shpenzimeve të pranueshme nuk mund ta kalon:</p> <ul style="list-style-type: none"> – 400 000 euro (24.574.840 në kundërvlerë denari) nga shpenzimet e përgjithshme të pranueshme të investimeve qëllimi i të cilës është që të arrihen standardet e Bashkësisë Evropiane pas realizimit të investimeve apo – 800 000 euro (49.149.680 në kundërvlerë denari) shpenzimet e përgjithshme të pranueshme të investimeve qëllimi i të cilës është pajtimi i plotë i kapaciteteve prodhuese me standardet e Bashkësisë Evropiane pas realizimit të investimeve. – 3.000.000 euro (184.311.300 në kundërvlerë denari) shpenzimet e përgjithshme të pranueshme të investimeve të cilat janë dedikuar për vendosjen e kapaciteteve të reja për thertore për shpezë plotësisht të përputhura me standardet e Bashkësisë Evropian. <p>Vlera maksimale e shpenzimeve të pranueshme për ko-financim të një shfrytëzuesi nuk mund të kalojë 1 100 000 në kuadër të periudhës financiare 2007-2013.</p> <p>Një shfrytëzues mund të dorëzon më shumë kërkesa për shfrytëzimin e mjeteve prej IPARD Programit 2007-2013, me kusht që të mos e kalon lerën maksimale të shpenzimeve të pranueshme për financim dhe nëse projektet e mëparshme janë me sukses të përfunduar, gjegjësisht përkrahja financiare është plotësisht e paguar.</p>
5.	Lënda dhe kushtet për shfrytëzimin e përkrahjes financiare për masën 302
	<p>Përkrahja financiare për masën 302 është dedikuar për popullatën rurale për investime në sektorët me prioritet përkrahje të mikro ndërmarrjeve në mjediset rurale (3021) dhe investime për promovimin e aktiviteteve prej turizmit rural përpunimin dhe plasmanin e pemëve dhe perimeve (3022). Investimet patjetër të realizohen në mjediset rurale.</p> <p>Grupet e investimeve të sektorëve me prioritet u dedikohen llojeve të investimeve në vijim:</p>
shifra	Lloj i investimit
30211	Investim për vendosjen e kapaciteteve përpunuese të ekonomive bujqësore dhe jashtë ekonomive bujqësore
30212	Investim për vendosjen dhe modernizimin e qendrave blerëse për kërpudha dhe bimë shëruese/aromatike dhe kapacitete për kultivimin e kërpudhave
30213	Investim për vendosjen e punëtorive të veprimtarive të zejeve tradicionale për qëndrueshmërinë e mekanizmit bujqësor
30221	Investim për rikonstruimin e objekteve të ekonomive bujqësore dedikuar për turizëm rural, dhe të plotësuara me kapacitete rekreuese
30222	Investime për ndërtimin e objekteve hotelerie, vendosje në ambient të hapur (kampe) dhe kapacitete rekreuese
5.1.	<p>Shfrytëzues masa 302 mund të jenë:</p> <p>a) Për vendosjen e kapaciteteve të ekonomive bujqësore shfrytëzues mund të jenë ekonomi bujqësore, persona juridik të cilët janë të regjistruar në Regjistrin e vetëm për ekonomi bujqësore në MBPE në pajtim me Ligjin për bujqësi dhe zhvillim rural ("Gaz. zyrtare e RM" nr. 134/2007)</p> <ul style="list-style-type: none"> - në pajtim me Ligjin për shoqata tregtare („Gaz. zyrtare e RM“ nr. 28/04, 84/05, 25/07, 87/08) në Regjistrin qendror si tregtar individ apo shoqata tregtare në rangun e mikro-ndërmarrjeve - në pajtim me Ligjin për veprimtari të zejtarisë („Gaz. zyrtare e RM“ nr. 62/04, 55/07) dhe të regjistruara në Odën e zejtarëve - janë të regjistruara për udhëheqje me përpunim të prodhimeve bujqësore në pajtim me Ligjin për sigurim të ushqimit dhe prodhimeve dhe materialeve që vijnë në kontakt me ushqimin („Gaz. zyrtare e RM“ nr. 28/04, 84/05, 25/07, 87/08) dhe Ligjin për shëndet bli veterinarie <p>b) Shfrytëzuesit të tjerë potencial mund të jenë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - tregtar individ dhe persona juridik që janë të regjistruar në pajtim me Ligjin për shoqata tregtare, në rangun e mikro-ndërmarrjeve dhe të cilat fillojnë me aktivitet në mjediset rurale - pronarë/koncesioner të fushave me peshq apo koncesioner të ujërave për peshkim sportive, për shfrytëzim më të mirë të vlerës ekonomike prej resurseve natyrore në pajtim me Ligjin për peshkim dhe



	<p>aktual të („Gaz. zyrtare e RM “ nr. 7/2008),</p> <ul style="list-style-type: none"> - pronarë të pyjeve për shfrytëzim sa më të mirë të vlerës ekonomike prej resurseve natyrore në pajtim me Ligjin për Pyje („Gaz. zyrtare e RM“ nr. 64/2009) <p>2) Madhësia e kapaciteteve prodhuese</p> <p>Madhësia e kapaciteteve të pranueshme prodhuese për investime për vendosjen e kapaciteteve përpunuese të ekonomive bujqësore dhe jashtë ekonomive bujqësore dhe jashtë ekonomive bujqësore:</p> <ul style="list-style-type: none"> - për përpunimin e pemëve dhe perimeve, kërkuesi duhet të posedojë ose blejë minimum 0,5 ha hapësirë me pemë ose perime - për përpunimin e qumështit, kërkuesi duhet të posedojë së paku 10 lopë për mjelje ose 150 dhen për mjelje ose 50 dhi për mjelje - për prodhimin dhe shitjen e mjaltit, kërkuesi duhet të posedojë së paku 30 familje bletësh - për përpunimin e bimëve shëruese/aromatike, kërkuesi duhet të posedojë ose huazojë së paku 0,75 ha tokë për bimë shëruese/aromatike të përmbajtura në Listën për bimë shëruese/aromatike në Pjesën 5 të Udhëzimit për përdoruesit e mjeteve sipas IPARD Programit 2007-2013 - Në rast të përpunimit dhe shitjes së kërpudhave, kërkuesi duhet të posedojë minimum 20m² për kultivimin e kërpudhave. - Përderisa kërkuesi investon në rikonstruimin e objekteve të ekonomive bujqësore deri në mbjelljen e vreshtave dhe/ose bodrumeve të verës për turizëm rural të përmbushura me kapacitete rekreative, kërkuesi duhet të ketë kapacitet të prodhimit minimal vjetor të ngjashëm me 20hl dhe kapacitet maksimal vjetor të prodhimit të ngjashëm me 400 <p>3) Kërkuesit duhet të dëshmojnë shkallë përkatëse të arsimit të mbaruar profesional gjegjësisht:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Në pajtueshmëri me Rregulloren për mënyrën e kontrollimit të njohurive dhe mënyrën e dhënies së vërtetimeve për arritje të njohurive fillestare për higjienë të ushqimit dhe mbrojtje të ambientit jetësor (Gazeta Zyrtare e RM nr. 118/05) dhe Ligjin për siguri të ushqimit (Gazeta Zyrtare e RM nr. 54/02, 84/07,) edhe prodhimet dhe materialet që vijnë në kontakt me ushqimin; - Në pajtueshmëri me Ligjin për arsim profesional dhe trajnim (Gazeta Zyrtare e RM nr. 71/06, 117/08), certifikata mund të merret në institucionet për arsim dhe përgatitje profesionale (shkolla për arsim profesional dhe qendra për përgatitje profesionale); - Zejtarët mund të kryejnë aktivitete zejtarie përderisa posedojnë arsim profesional përkatës ose aftësi profesionale përkatëse për kryerjen e aktiviteteve të caktuara zejtare. - Personi përgjegjës për subjektin ligjor nuk mund të jetë më i vjetër se 59 vjet për meshkujt dhe 57 vjet për femrat, duke e marrë parasysh kufirin e moshës për pensionim prej 64 vjetëve për meshkujt dhe 62 vjetëve për femrat në pajtueshmëri me urdhrat nga Ligji për sigurim pensional dhe invalidor (Gazeta Zyrtare e RM nr. 80/93, 14/95, 71/96, 32/97, 24/00, 96/00, 5/01, 85/03, 50/04, 4/05, 84/05, 101/05 , 70/06), 153/07, 152/08, 161/08, 81/09) - Personi përgjegjës në subjektin ligjor duhet të jetë në marrëdhënie të rregullt pune.
5.2.	<p>Lartësia e financimit sipas masës 302</p> <p>Vlera minimale e shpenzimeve të pranueshme është 5 000 euro (307.185 në kundërvlerë denarë)</p> <p>Vlera maksimale e shpenzimeve të pranueshme nuk duhet të kalojë shumën prej 200.000 euro (12.287.420 në kundërvlerë denarë)</p> <p>Kufizime të tjera financiare të cilat aplikohen:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Shpenzimet e pranueshme të përgjithshme të aktiviteteve turistike (vende në shitje, hapësira për degustim të verës dhe kapacitete rekreative) nuk duhet të kalojë mbi 25% nga shpenzimet e arsyeshme të përgjithshme të investimeve (në përjashtim të gjithsej shpenzimeve të arsyeshme të përgjithshme) të parapara në kornizën e buxhetit të projektit, përderisa projekti në tërësi ka për qëllim rikonstruimin e objekteve të ekonomisë bujqësore të dedikuara për turizëm rural; <p>Shuma e përgjithshme maksimale e shpenzimeve të pranueshme për ko-financim të një shfrytëzuesi nuk duhet të jetë mbi 250 000 euro në kuadër të periudhës financuese 2007-2013.</p> <p>Një shfrytëzues mund të dorëzon më shumë kërkesa për përdorimin e mjeteve nga IPARD Programit 2007-2013, me kusht që të mos kalojë shumën e përgjithshme maksimale të shpenzimeve të arsyeshme për financim dhe përderisa projektet e kaluara kanë pasur përfundim të suksesshëm, gjegjësisht përkrahja financiare tërësisht është paguar.</p>



6.	Shpenzimet e arsyeshme të përgjithshme
	<p>Shpenzimet e pranueshme për ko-financim kanë të bëjnë me:</p> <ul style="list-style-type: none"> a) ndërtim ose rindërtim të objekteve b) furnizim të mbjelljeve shumëvjeçare c) furnizim të makinave dhe përgatitjeve të reja, duke i inkuadruar softuerët kompjuterik në shumë të vlerës së tregut të mjeteve ç) shpenzime të përgjithshme të lidhura me shpenzime të pranueshme të dhëna në pikat a), b), dhe c) siç janë arkitektë, inxhinierë dhe shpenzime të tjera konsultative, fizibilitet studime, fitimin e të drejtave dhe licencave në shumë maksimale prej 12% nga shpenzimet e pranueshme të përgjithshme të dhëna në pikat a), b), dhe c) dhe janë në pajtueshmëri me kushtet në vijim: <ul style="list-style-type: none"> - për projektet me gjithsej shpenzime të pranueshme të investimeve të dhëna në pikat a), b) dhe c) mes 1.000.000 eurove ose në kundërvlerë prej 61.437.100 denarëve dhe 3.000.000 eurove ose në kundërvlerë prej 614.371.000, shpenzimet e përpilimit të planit të punës nuk mund të jenë më të mëdha se 4% nga shpenzimet e arsyeshme të këtyre investimeve, dhe - për projektet me gjithsej shpenzime të pranueshme të investimeve të dhëna në pikat a), b) dhe c) më të vogla se 1.000.000 euro ose në kundërvlerë prej 184.311.300 denarëve, shpenzimet për përpunimin e përpilimit të planit të punës nuk mund të jenë më të mëdha se 5% nga shpenzimet e arsyeshme të këtyre investimeve dhe <p>Shpenzimet e pranueshme sipas llojeve janë të dhëna detajisht në Udhëzimin për përdoruesit e mjeteve sipas IPARD Programit 2007-2013.</p> <p>Kërkuesit duhet të paraqesin dëshmi për prejardhjen e kofinancimit të makinave dhe përgatitjeve të reja nga vendet anëtare të Bashkësisë Evropiane, vendet kandidatë për anëtarësim në Bashkësisë Evropiane, vendet kandidat potencial për anëtarësim në Bashkësisë Evropiane dhe vendet shfrytëzues të instrumentit "Fqinjësi dhe partneritet evropian" dhe vende të tjera të cilat kanë qasje reciproke në ndihmën e jashtme të Bashkësisë Evropiane. Lista e këtyre vendeve është e dhënë në Udhëzimin për shfrytëzuesit të mjeteve sipas IPARD Programit 2007-2013</p>
7.	Shpenzimet e papranueshme
	<p>Shpenzimet në vijim nuk janë të pranueshme për ko-financim:</p> <ul style="list-style-type: none"> - tatime, duke inkuadruar edhe tatimin e vlerës së shtuar; - tatime doganore dhe tatime tjera importi, ose tatime tjera; - blerje, huamarrje ose qira të tokës dhe objekteve ekzistuese, pavarësisht nga ajo nëse qiraja do të sjellë deri te transferimi i pronësisë të qiramarrësit; - dënime, dënime financiare dhe shpenzime nga kontestet gjyqësore; - shpenzime operative; - pajisje dhe makina të përdorura; - tatime bankare, shpenzime për garanci dhe tatime të ngjashme; - shpenzime për konvertim, tatime dhe humbje nga kursi devizor të lidhur me llogarinë në euro të IPARD, si dhe vetëm shpenzime tjera financiare; - kontribute në natyrë; - blerje të të drejtave për prodhime bujqësore, blegtori, bimë vjetore dhe kultivimin e tyre; - çfarëdo mirëmbajtje, amortizim dhe shpenzime për qira; - shpenzime të administratës publike në udhëheqjen dhe zbatimin e ndihmës, pikërisht të atyre në strukturën operative dhe, posaçërisht shpenzimet e regjisë, qiratë dhe rogat e personelit të angazhuar për aktivitete të udhëheqjes, aplikimit, përcjelljes së kontrollit.
8.	Llogaritja e kursit të euros
	<p>Shumat e shprehura në euro llogariten në kundërvlerë denarë sipas kursit të mesëm të euros të vërtetuar nga Banka qendrore evropiane. Për muajin dhjetor 2009, kursi i euros është 61,437100 denarë për 1 euro (www.ec.europa.eu/budget/infocuro).</p>
9.	Afati për realizimin e investimit



	Periudha e pranueshme për realizimin e secilit investim është më së shumti 24 muaj nga dita e nënshkrimit të Marrëveshjes për përdorim të mjeteve.
10.	Kriteret dhe kushtet e përgjithshme për shfrytëzim
	<p>Kërkuesi duhet të mbushë dhe dorëzojë Kërkesë për shfrytëzim të mjeteve sipas masës përkatëse si dhe:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. plani afarist, me të cilin tregohet qëndrueshmëria/llogaria ekonomike dhe mundësia për punësime të reja i cili përpilohet në pajtim me Udhëzimin për përpilimin e planit afarist; 2. dokumentacioni për procedurë të kryer për mbledhjen e të paktën tre ofertave nga ofrues të ndryshëm të pavarur me specifikimet teknike dhe vendin e prejardhjes për secilin furnizim, mall dhe shërbim veç e veç, si dhe deklarata nga ana e prodhuesit për vendin e prejardhjes së prodhimeve të ofruara, përderisa vlera e përcaktimit individual paraqet shumën më tepër se 10.000 euro, ose në kundërvlerë prej 614.371 denarë, gjegjësisht një ofertë nga një ofrues i pavarur me specifikimet teknik dhe vend të prejardhjes për secilin furnizim individual të mallrave dhe shërbimeve si dhe deklarata të prodhuesit për vendin e prejardhjes së prodhimeve të ofruara , përderisa vlera është nën 10.000 euro ose në kundërvlerë prej 614.371 denarë. Ofertat duhet të jenë të mbledhura nga persona me të cilët kërkuesi nuk ka lidhje personale dhe farefisnore dhe/ose furnizues që nuk kanë marrëdhënie mes veti në lidhje me pronën. 3. dëshmi për pagimin e tatimeve, në bazë të tatimeve dhe kontributeve ndaj shtetit në bazë të sigurimit shëndetësor, pensional dhe social, 4. dëshmi për pagimin e detyrimeve ndaj Ministrisë së bujqësisë, pylltarisë dhe ekonomisë së ujërave në bazë të marrëveshjes për masën 101 dhe masën 103, 5. dëshmi për sigurimin e mjeteve financiare për realizimin e investimit për masën 103 – investime për përpunim dhe marketing të prodhimeve bujqësore dhe të peshkut me ristrukturimin dhe mbindërtimin e tyre për arritjen e standardeve të Bashkimit Evropian, 6. dëshmi se është pronar i tokës bujqësore ose ka marrëveshje për qira ose të drejtë për shfrytëzim të tokës bujqësore për më së paku 5 vjet gjegjësisht 10 vjet në rast kur investimet kanë të bëjnë me përtëritjen e të mbjellave. 7. dëshmi se është pronar i një objekti ose ka marrëveshje për qira ose të drejtë shfrytëzimi të objektit për më së paku 5 vjet gjegjësisht 10 vjet në rast kur investimet kanë të bëjnë edhe me punët ndërtimore. Në rast të ndërtimit të një objekti të ri, duhet të dorëzohet dëshmi për pronësi të tokës për ndërtim, 8. të përgatit dhe dorëzon dokumentacion projektues së bashku me planet për ndërtim/rindërtim në qoftë se investimi përfshin edhe punët ndërtimore, 9. dëshmi për shpenzimet e përgjithshme të bëra dhe shpenzimet për përpilimin e planit afarist të bëra pas 01.01.2007, 10. dëshmi për pajtueshmëri të investimit me Strategjinë për zhvillim lokal të komunës në të cilën gjendet investimi. Përderisa komuna ende nuk e ka aprovuar Strategjinë për zhvillim lokal në kohën e dorëzimit të kërkesës për shfrytëzimin e mjeteve, kërkuesi në planin afarist bashkëngjit analizën e kontributit të investimit për zhvillimin ekonomik lokal në komunën në të cilën gjendet investimi dhe 11. mendim nga trup profesional përkatës për përmbushjen e kriterëve dhe standardeve nga IPARD Programi 2007-2013 në lidhje me investimet. <p>Investimet duhet ti plotësojnë standardet minimale nacionale për mbrojtje të ambientit jetësor, shëndetësisë publike, shëndetin e kafshëve dhe bimëve, begatinë e kafshëve dhe mbrojtja gjatë punës deri në momentin kur të silltet vendim për aprovim të përkrahjes financiare .</p> <p>Në rast kur standardet nacionale minimale të cilat janë në pajtim me standardet e Bashkimit Evropian, janë zbatime të reja në periudhën kur kërkesa për përkrahje financiare është dorëzuar, përkrahja mund të ndahet pa dallim të papërshtatshmërisë me standardet por me kusht që zbatimet e reja të standardeve të arrihen me realizimin e investimit.</p> <p>Kërkuesit duhet të dorëzojnë kërkesa për përdorimin e mjeteve nga IPARD Programi 2007-2013 për</p>



	<p>masa individuale, plan afarist me të cilin i përshkruajnë llojet e planifikuara të investimeve dhe dokumentacionin e bashkangjitur të cekur në Kërkesë për përdorim të mjeteve nga IPARD Programi 2007-2013. Dokumentet të cilat jepen në bazë të librave publik ose sistemit institucionale të evidentimit nuk duhet të jenë më të vjetër se tre muaj nga dita e publikimit në shpalljen publike.</p> <p>Në pajtueshmëri me Rregullimin për mënyrën dhe procesin e përdorimit të përkrahjes financiare për masat e zhvillimit rural të financuara nga ana e Komponentit V – IPARD nga instrumenti për ndihmë para anëtarësimi IPA (“Gazeta Zyrtare e RM” nr. 112/09) dokumentet të cilat dorëzohen në mbështetje të kërkesës për përdorim të mjeteve duhet të jenë në origjinal në gjuhën maqedonase ose kopje të vulosur në noter. Nëse dokumentacioni është në gjuhë tjetër e njëjta duhet të jetë e shoqëruar me përkthim në gjuhën maqedonase e vulosur nga përkthyes zyrtar, mirëpo nëse bëhet fjalë për dokument zyrtar të një shteti tjetër atëherë duhet të jetë e verifikuar me apostil</p> <p>Informata më të detajuara për kërkesa specifike për pranueshmëri janë të shprehura në Udhëzim për shfrytëzuesit e mjeteve sipas IPARD Programit 2007-2013.</p>
11.	<p>Procedura para Agjencisë</p> <p>1. Procedura e Agjencisë prej pranimit të Kërkesave deri në realizimin e marrëveshjes për shfrytëzimin e mjeteve përbëhet nga:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Kontroll të kompletimit të dokumenteve të dorëzuara në pajtueshmëri me dokumentet e kërkuara sipas masave dhe llojeve të investimeve dhe atë: • Nëse dokumentet janë të dhëna nga institucionet përkatëse; • Nëse dokumentet i posedojnë të gjitha elementet me të cilat dëshmojnë se janë të besueshme (vulë, nënshkrim të personit përgjegjës, datë etj.) • Nëse dokumentet janë me afat të vazhdimi i cili është i cekur në <i>Kërkesën për shfrytëzimin e mjeteve</i>; <p>Kërkuesi duhet të kryejë plotësim të kërkesave të paplotësuara për shfrytëzimin e mjeteve në bazë të lajmërimit të fituar me shkrim nga ana e Agjencisë. Afati për plotësimin e kërkesave të paplotësuara nuk mund të jetë më i shkurt se 8 ditë.</p> <p>2. Kontroll të përshtatshmërisë së kërkesës për shfrytëzim të mjeteve bëhet me qëllim që të vërtetohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Nëse dokumentet e dorëzuara argumentojnë plotësim të kritereve dhe kushteve për pranueshmëri të aktiviteteve të propozuara investuese; • Nëse investimi i propozuar është ekonomikisht dhe financiarisht e realizueshme, e cila kontrollohet përmes analizës së parametrave të përmbajtur në planin e bashkëngjitur afarist; • Nëse investimi i propozuar për të cilin kërkohet përkrahje financiare nuk është i financuar nga burime të tjera publike të mjeteve (Buxheti i Republikës së Maqedonisë dhe donatorët ndërkombëtar); • Nëse çmimet e aktiviteteve të propozuara investuese janë në kuadër të çmimeve të tregut përmes analizës së çmimeve referente për aktivitete përkatëse. <p>Me qëllim të vërtetimit të autenticitetit të parametrave teknik, të dhënave ekonomike dhe financiare, Agjencia ka të drejtë të kërkojë dokumente dhe informata shtesë si bazë për sjelljen e vendimit.</p> <p>Verifikimin e besueshmërisë së të dhënave në Kërkesën për shfrytëzim të mjeteve e kryejnë persona të autorizuar të Agjencisë me kontrollim në vendin e ngjarjes.</p> <p>Rangimi bëhet i të gjitha kërkesave të kompletuara dhe të përshtatshme për shfrytëzimin e mjeteve në pajtueshmëri me tabelat e paraqitura për rangim sipas masave më të veçuara.</p> <p>Përkrahja financiare do të aprovohet për të gjitha kërkesat e kompletuara dhe të përshtatshme për shfrytëzimin e mjeteve në kuadër të mjeteve në dispozicion sipas masës në bazë të kontrollimit administrativ të bërë në vend të ngjarjes.</p> <p>Kërkesat e pakompletuara dhe jo përkatës, si dhe kërkesa për shfrytëzimin e mjeteve të cilët kanë numër më të vogël të pikëve në lidhje me mjetet në dispozicion sipas masës, do të jenë të refuzuara me Vendim.</p> <p>Me kërkuesin, kërkesa e të cilit për shfrytëzim të mjeteve është e refuzuar, nënshkruhet Marrëveshje në afat prej 30 ditëve nga dita e marrjes së Vendimit për aprovim të mjeteve nga IPARD Programi.</p>



Kërkuesit nuk guxojnë të fillojnë me realizimin e investimeve para nënshkrimit të Marrëveshjes për shfrytëzim të mjeteve me Agjencinë, në përjashtim të aktiviteteve të lidhura me shpenzimet e përgjithshme (përpilimin e planit afarist, fizibili studimit, arkitektët, dokumentacioni për projekte).

Pas mbarimit të investimit, kërkuesi është i detyruar të dorëzojë në Agjenci kërkesë për pagesë në afatin e vërtetuar në Marrëveshje për shfrytëzimin e mjeteve.

Kërkuesi i cili do të nënshkruajë marrëveshje me Agjencinë është i obliguar që investimin që është lëndë e marrëveshjes mos ta huazojë, mos ta japë me qira, mos t'ia ndërrojë synimin dhe lokacionin e të njëjtës gjatë tërë kohës së marrëveshjes gjegjësisht 5 vjet nga pagesa e fundit të mjeteve financiare.

Kontrollim në vend të ngjarjes dhe aplikim të mbikëqyrjes ndaj marrëveshjes bëjnë persona të autorizuar nga institucionet relevante të Republikës së Maqedonisë dhe Bashkimit Evropian.

Në pajtim me Ligjin për themelimin e Agjencisë për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural, Agjencia vendos në lidhje me kërkesën e dorëzuar për shfrytëzimin e mjeteve gjegjësisht kërkesë për pagim më së voni në afat prej tre muajve nga dita e mbarimit të afatit për dorëzim të kërkesës për përdorim të mjeteve, gjegjësisht të Thirrjes publike për dorëzim të kërkesave për shfrytëzim të mjeteve dhe tre muaj nga dita e pranimit të kërkesës për pagim.

Kërkesat për shfrytëzim të mjeteve, si dhe dokumentet e bashkëngjitura nuk kthehen.

12. Kriteret për zgjedhje të përdoruesve

12.1. Kriteret për rangim të kërkesave sipas masës 101

Kërkesat të cilat i plotësojnë kushtet për shfrytëzimin e përkrahjes financiare për masën 101 rangohen me pika në këtë mënyrë:

	Qëllimet e masave	TREGUES	Pikat në rast të përmbushjes	Maks.
1	Përkrahja e shoqatave të zejtarëve dhe aktiviteteve zejtare	Përderisa investimi është propozuar nga ana e bujqve individual, të cilët janë anëtarë të kooperativës bujqësore ose shoqatave të bujqve	35	35
		Përderisa investimi është e propozuar nga kooperativa bujqësore	30	
		Përderisa investimi është e propozuar nga persona ligjor të përcaktuar nga shoqatat e bujqve	25	
2	Përparimi i mbrojtjes së rrethinës	Përderisa investimi është i orientuar drejt vendosjes së sistemit për kursim të energjisë dhe kursimit të ujit në ekonominë bujqësore, si dhe përparim të praktikave bujqësore për mbrojtje të ambientit jetësor	25	25
3	Përmirësim të strukturës gjinore dhe moshës në hapësirat rurale	Përderisa bartës të ekonomisë bujqësore për të cilën është e dhënë investimi është grua	15	30
		Përderisa investimi është i propozuar nga ana e bujqve të rinj (mes moshës 18 dhe 40)	15	
4	Orientim i tregtarit prodhimit bujqësor	Përderisa dorëzimi i prodhimit primar të prodhuar në ekonominë bujqësore në rrjetin e tregut për ushqim është në rrugë të marrëdhënieve të marrëveshjes	10	10
			GJITHSEJ	100



12.2.

Kriteret për rangim të kërkesave sipas masës 103

Kërkesat të cilat i përmbushin kushtet për përdorim të përkrahjes financiare për masën 103 janë të ranguar në këtë mënyrë:

	Qëllimet e masës	TREGUES	Pikat në rast të përmbushjes	Maks. pikë
1	Qëllim të projektit	Përderisa investimi është për qëllim të modernizimit dhe përkryerjes teknologjike të ndërmarrjeve ekzistuese gjatë kohës së mbylljes së ndërmarrjeve të vjetra	30	30
		Përderisa investimet kanë për qëllim hapjen e qendrave për mbledhjen e pemëve dhe perimeve të freskëta dhe qumështit të papërpunuar ose thertoreve për kafshë.	25	
		Përderisa investimet kanë për qëllim modernizimin dhe përsosurinë teknologjike të ndërmarrjeve ekzistuese me qëllim të rritjes së kualitetit të prodhimit.	20	
2	Mbrojtja e ambientit jetësor	Përderisa investimi ka për qëllim zvogëlimin e ndikimit negativ ndaj ambientit jetësor përmes pastrimit të ujit	15	30
		Përderisa investimet kanë për qëllim pastrimin e mbeturinave dhe riciklimin në kohën e valorizimit të nus prodhimeve	15	
3	Kontrolli i përmirësuar të kualitetit të prodhimeve	Përderisa investimet kanë për qëllim hapjen e laboratorëve ose modernizim të atyre ekzistues	15	25
		Përderisa investimet kanë për qëllim pajisjet për mbikëqyrje të kualitetit, sistemeve për kontrollim dhe përcjellje	10	
4	Marrëdhënie të kontraktuara me prodhues individual bujqësor	Përderisa investimi ka të bëjë me modernizimin e ndërmarrjeve ekzistuese, ndërsa furnizimet personale dhe marrëdhëniet e kontraktuara me prodhues bujqësor individual përfshijnë më së paku 50% të furnizimeve dhe kanë të bëjnë me periudhën prej më pak se një vjet	15	15
		Përderisa bëhet fjalë për investime të reja, ndërsa furnizimet personale dhe marrëdhëniet kontraktuese me prodhuesit bujqësor individual përfshijnë më së paku 50% të furnizimeve të lëndëve të para për periudhën prej më pak se një vit pas përfundimit të projektit.	10	
	GJITHSEJ	100		



	Qëllimet e masës	TREGUES	Pikat në rast të përmbushjes	Maks. pikë
1	Qëllimi i projektit	Përderisa shfrytëzuesi është kompani për përpunimin e mishit	40	40
		Përderisa shfrytëzuesi është thertore	30	
2	Mbrojtje të ambientit jetësor	Përderisa shfrytëzuesi ka lidhje me kanalizimin publik	30	30
		Përderisa shfrytëzuesi përdor gropa për ujëra të zeza si sistem e kanalizimit	20	
3	Ndihmë për gra dhe të rinj si operator ekonomik	Përderisa personi përgjegjës ndaj personit ligjor është grua	15	30
		Përderisa investimi është propozuar nga operatorë të ri ekonomik të moshës prej 18 deri 40 vjet	15	
			GJITHSEJ	100



12.3.

Kritere për rangim të kërkesave sipas masës 302

Kërkesat të cilat i përmbushin kushtet për shfrytëzim të përkrahjes financiare për masën 302 rangohen me pika në këtë mënyrë:

	Qëllimet e masës	TREGUES	Pikat në rast të përmbushjes	Maks.pikë
1	Lokacioni i projektit	Përderisa investimi është e locuar në komunat me qendra rurale, vendbanime malore dhe kodrinore, zona kufitare, zona të pazhvilluara ekonomike ose specifike	15	35
		Përderisa investimi është i locuar në komunë e cila gjendet në afërsi të zonës së mbrojtur në pajtim me Ligjin për mbrojtje të natyrës (Gazeta Zyrtare e RM nr. 67/04, 14/06, 84/07)	10	
		Përderisa investimi është i locuar në komunën e cila është e afërt me trashëgiminë kulturore ose gjetjet arkeologjike e cila është e emëruar në pajtim me Ligjin për mbrojtje të trashëgimisë kulturore (Gazeta Zyrtare e RM nr. 20/04, 115/07)	10	
2	Krijimi i mundësive për punësim	Përderisa investimi parasheh mundësi për punësim të më së paku 5 ndërsa më së shumti 10 personave	15	15
		Përderisa investimi parasheh mundësi për më së paku tre punësime të reja	10	
		Përderisa investimi parasheh mundësi për më së paku një punësimi të ri	5	
3	Mbrojtja e traditës dhe trashëgimisë	Përderisa investimet i respektojnë në cilësi tradicionale nga hapësirat rurale atje ku janë të locuara (pamja tradicionale e ndërtimeve të jashtme dhe të brendshme, recetat tradicionale, kuzhina, zejet etj.)	20	20
4	Promovimi i veprimtarive bashkëpunuese	Përderisa bëhet fjalë për projekte të përbashkëta të cilat kërkojnë partneritete private mes operatorëve të ndryshëm ekonomik rural	10	10
5	Përmirësimi i strukturës gjinore dhe moshës në hapësirat rurale	Përderisa personi përgjegjës ndaj personit ligjor është grua gjegjësisht udhëheqës i ekonomisë bujqësore për të cilën dërgohet investimi është grua	10	20
		Përderisa investimi është i promovuar nga persona të moshës prej 18 deri 40 vjet	10	
			GJITHSEJ	100

